



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/03 prill 2017) si dhe neneve 103 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2025, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE FUNKSIONIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për Kontrolltet e Brendshme dhe Funksonimin e Auditimit të Brendshëm të Institucioneve Mikrofinanciare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 29 gusht 2013 (më tutje: rregullorja bazë).

### **Neni 2**

1. Nënparagrafi b. i paragrafit 8 të nenit 9 të rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:
  - b. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet:
    - i. të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Rregullores për Regjistrimin e Institucioneve Mikrofinanciare;
    - ii. Të jetë i certifikuar në fushën e auditimit nga ndonjë:
      - 1.1.1. institucion i akredituar në Kosovë për këtë qëllim;
      - 1.1.2. institucion i mirënjohur ndërkombëtar; apo
      - 1.1.3. institucion relevant i akredituar për këtë qëllim nga organi kompetent në vendin në të cilin është themeluar për ofrimin e shërbimeve të certifikimit në fushën e auditimit.
    - iii. të jetë individ me reputacion të lartë etik dhe profesional dhe me një përvojë adekuate në fushën e auditimit.

**Neni 3**  
**Dispozitat kalimtare**

Institucionet mikrofinanciare duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj Rregulloreje brenda afatit prej 2 (dy) vite nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

**Neni 4**  
**Efektet dhe hyrja në fuqi**

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë mbesin në fuqi, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë Rregullore të cilat kanë efekt nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.
2. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e rregullores bazë.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi me datë 1 mars 2025.

Dr.sc. Bashkim Nurboja  
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës